




Projekt i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



RRITJA E PUNËSIMIT TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI, DHE EGJIPTIAN NËPËRMJET NJË KOLEKTIVI TË RICIKLIMIT

*Përmbajtja e kësaj broshure nuk pasqyron opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian.
Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë broshurë janë përgjegjësi e plotë e autorit(-ve).*

Implementuar nga:



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Në partneritet me:

Health For All



CILI ËSHTË QËLLIMI I PROJEKTIT?

Projekti synon të rrisë mundësitë e vetë-punësimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët, në mënyrë joformale, janë të angazhuar në mbledhjen e materialeve të riciklueshme, të cilën ata më pas e shesin për të jetuar nga paratë e fituara. Projekti synon të ofrojë mbështetje për këta pjesëtarë duke përdorur dhe zgjeruar modelin ekzistues të biznesit që ata tashmë kanë krijuar për të përmirësuar aftësitë e tyre, për të rritur qasjen e tyre në burimet si dhe kapacitetet për mbledhjen e materialeve të riciklueshme.

Me qëllim të zyrtarizimit të modelit të tyre aktual të biznes bërjes, projekti synon të nxisë dhe mbështesë format e përbashkëta të bashkëpunimit sipërmarrës në mes të mbledhësve joformalë nëpërmjet krijimit të një shoqate të përbashkët, e cila gjithashtu u ofron atyre një platformë për t'u angazhuar me institucionet publike në debatin e vazhdueshëm për riorganizimin e menaxhimit të mbeturinave dhe procesin e riciklimit në Kosovë.

65

US

10

9



GRUPET E SYNUARA DHE PËRFITUESIT

Grupi kryesor i synuar janë gjashtëdhjetë (60) pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të angazhuar në mbledhjen joformale të materialeve të riciklueshme në pesë (5) komunat e përzgjedhura të veprimeve të projektit: Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan, Graçanicë dhe Obiliq. Më gjerësisht, projekti mbështet familjet e mbledhësve joformalë të mbeturinave, duke krijuar mundësi për rritjen e të ardhurave nga puna në të cilën ata janë të angazhuar.





REZULTATET E ARRITURA DHE TË PRITSHME

Projekti ka filluar së zbatuari në dhjetor të vitit 2014 dhe pritet të finalizohet me sukses në dhjetor të vitit 2016. Gjatë kësaj periudhe, janë arritur rezultate të shumta dhe disa të tjera pritet që arrihen deri në përfundimin e projektit. Duke shfrytëzuar iniciativat ekzistuese të riciklimit dhe modelet e biznesit brenda komunitetit të mbledhësve joformalë të materialeve të riciklueshme, projekti ka rritur kapacitetet njerëzore, ligjore dhe infrastrukturore të përfituesve nëpërmjet:

- Organizimit të një serie të trajnimeve të specializuara për gjashtëdhjetë (60) përfituesit e projektit – që kanë qenë të dizajnuara për të përmirësuar aftësitë, njohuritë dhe ndërmarrësinë e vogël familjare.
- Ofrimit të pajisjeve të rëndësishme infrastrukturore, për pesëmbëdhjetë (15) përfituesit e projektit, janë ofruar moto-kultivator dhe biçikleta me tri rrota me rimorkio me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre vepruese;
- Ngritjes së katër (4) qendrave të grumbullimit të materialeve të riciklueshme, të pajisura me makina shtypëse të kapacitetit të lartë dhe me peshore për përpunimin dhe kompresimin e materialeve të riciklueshme;
- Ofrimit të uniformave të nevojshme dhe veshjes mbrojtëse -- të gjithë përfituesve -- duke i lejuar ata që të trajtojnë materialet e riciklueshme duke mbrojtur shëndetin e tyre;

- Krijimit dhe mbështetjes së Shoqatës së mbledhësve joformalë të mbe-turinave -- Iniciativë për riciklim kolektiv në Kosovë ("Collective Recycling Initiative Kosovo" - CRIK) në hartimin dhe zbatimin e të gjithë kuadrit ligjor të nevojshëm (Statutit, Rregullores së Punës, Bordit të Drejtorëve);
- Mbështetjes dhënë Shoqatës duke iu ofruar ekspertizë teknike dhe ligjore marrë parasysh se shoqata synon të zhvillohet në një platformë të përbashkët për mbledhësit joformalë për të avokuar për të drejtat e tyre në fushat e punësimit, arsimin dhe përfaqësimit më të mirë të komuniteteve përkatëse;
- Ndërmarrjes së një fushate të ndërgjegjësimit për të informuar publikun e gjerë në lidhje me efektin pozitiv që mbledhësit joformalë kanë për ekonominë e tyre familjare dhe për ambientin, gjë kjo që ndikon drejtpërdrejtë në uljen e stigmatizimit të punës dhe profesionit të tyre;
- Krijimit dhe menaxhimit të suksesshëm të një skeme të kursimit-dhe-kredisë duke ofruar stimuj financiarë për përfituesit e veprimeve të projektit me qëllimin përfundimtar të rritjes së normës së tyre të kursimit drejt një planifikimi më të mirë financiar.

Përmes ofrimit të trajnimeve të nevojshme dhe subvencioneve infrastrukturore të cilat në mënyrë të konsiderueshme rrisin kapacitetin e tyre për të mbledhur, transportuar, dhe procesuar materialet e riciklueshme, njëzet (20) mbledhës joformalë tani janë plotësisht të vetë-punësuar dhe kanë mjetet dhe kapacitetet e nevojshme për të rritur në mënyrë të konsiderueshme të ardhurat e tyre.

Si rezultat i kësaj:

- Pesëmbëdhjetë(15)përfitues janë të vetë-punësuar në mbledhje dhe transportim të materialeve të riciklueshme në qendrat e grumbullimit
- Gjashtë(6)përfitues janë të vetë-punësuar në Qendrat e Grumbullimit në operimin e maqinerisë dhe procesimin e materialeve
- Përafërsisht 20 tonë (20,000kg) të materialeve janë grumbulluar, transportuar, procesuar dhe kompresuar (në formë të dengjeve) që nga fillimi i projektit
- Përafërsisht 15 tonë (15,000kg) të materialeve të riciklueshme janë shitur tek kompanitë më të mëdha, duke gjeneruar kështu të hyra për përfituesit që nga fillimi i projektit
- Të hyrat për mbledhësit joformalë janë rritur për shkak të:
 - ▶ Nivelit më të lartë të mbledhjes si rezultat i transportimit më të shpejtë dhe efikas duke ulur kohën e transportit nga mbledhja deri tek pikëshitja në mënyrë të ndjeshme
 - ▶ Kompresimit dhe krijimit të dengjeve (“ballave”) nga vetë mbledhësit joformalë me anë të maqinerisë së ofruar tyre nga projekti, duke rritur kështu çmimin e shitjes së produktit në treg
- Strukturat ekzistuese (ligjore dhe infrastrukturore) do të vazhdojnë të jenë funksionale edhe pas përfundimit të projektit, duke siguruar kështu qëndrueshmëri dhe efekt afatgjatë.

RRETH NESH

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova) është organizata kryesore joqeveritare (OJQ) që merret me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve minoritare në Kosovë. Qëllimi ynë kryesor është që të kontribuojmë në zhvillimin e një shoqërie shumetnike përfshirëse, demokratike dhe të qëndrueshme në Kosovë.

ECMI Kosova është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të projektit, të cilin e zbaton në partneritet me organizatën Shëndeti për të Gjithë (HFA) dhe Qendrën romë dhe Ashkali për Dokumentim (RADK), të dyja organizata joqeveritare me përvojë të gjerë në çështjet që lidhen me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas. Për të arritur këtë ajo bazohet në një përvojë të gjatë në mbështetjen e institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile në një sërë fushash të shumëllojshme, përfshirë punësimin, arsimin dhe sektorët e ngritjes së kapaciteteve.



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

NA KONTAKTONI

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova)

Personi për kontakt: Trim Kabashi

Email: kabashi@ecmikosovo.org

Tel.: +381 (0) 38 224 473

Adresa: Rr. Nëna Terezë nr. 20, Apt, 5 10000 Prishtinë, Kosovë

Shëndeti për të Gjithë (HFA)

Personi për kontakt: Gzim Hoti

Email: gzim.hoti7@gmail.com

Tel.: +377 (0) 44 372 734

Qendra "Fidan Lahu" pn, Fushë Kosovë, Kosovë 10000

Qendra Rome dhe Ashkali për Dokumentim

Personi për kontakt: Bekim Sylja

Email: radcenter1@gmail.com

Tel.: +377 (0) 44 360 901

Adresa: Shaip Spahia B-I-15, Prishtinë/Priština, Kosovë 10000

ECMI Kosovo
Str. Nëna Terezë Nr.41, Apt.29
10000 Prishtinë/Priština, Kosovo
Tel. +381 (0) 38 224 473

Str. Kralja Petra 183a
38220 Mitrovica/ë North, Kosovo
+381 (0) 64 433 10 40

Email: info@ecmikosovo.org
Web: www.ecmikosovo.org



Projekt i financuar nga BE dhe menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë